



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1013/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Milena Đerić kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Mitrovicës së Jugut Gjergj Beka nga radhët e Subjektit Politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicën e Jugut, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1013/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Mitrovicës së Jugut Gjergj Beka nga radhët e Subjektit Politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicën e Jugut, me të cilën ka kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave në vendvotimet 1102B/07R, 1122B/01R dhe 1122B/02D në Mitrovicën e Jugut.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Mitrovicës së Jugut Gjergj Beka nga radhët e Subjektit Politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicën e Jugut me të cilën ka pretenduar se në vendvotimet 1102B/07R, 1122B/01R dhe 1122B/02D, ka pasur parregullsi për arsye se ka mospërputhje të rezultateve të subjektit dhe kandidatëve nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re.

Si dëshmi ka bashkangjitur Formularët e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve dhe Formularët e Rezultateve të Kandidatëve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se apeli i parashtruar nga Gjergj Beka, kandidat për Kuvend Komunal në Mitrovicën e Jugut nga radhët e Subjektit Politik Aleanca Kosova e Re më të cilën ka kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesen, e në rastin konkret, Paneli verifikoi provat e ofruara si dëshmi nga apeluesi që ishin Formularët e Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve dhe Formularët e Rezultateve të Kandidatëve nga të cilat formularë rezultoi se Subjekti Politik AKR në vendvotimet e apeluar ka numër saktësisht të njëjtë me kandidatët nga radhët e këtij subjekti, ashtu që në vendvotimin 1102B/07R Subjekti Politik AKR ka 7 vota ndërsa kandidatët nga ky subjekt së bashku kanë po ashtu 7 vota, në vendvotimin 1122B/01R Subjekti Politik AKR ka 6 vota ndërsa kandidatët nga ky subjekt së bashku kanë po ashtu 6 vota si dhe në vendvotimin 1122B/02D Subjekti Politik AKR ka 7 vota ndërsa kandidatët nga ky subjekt së bashku kanë po ashtu 7 vota.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Gjergj Beka kandidat për Kuvend Komunal nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1013/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuesja e Panelit
Milena Đerić



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.